

ARLIND FARIZI DY KOHËT E PERSONAZHIT KADAREAN

821.18-31.09

Rolan Barthesi-i është i interesuar për relacionin *kohë-letërsi*. Ai shtron pyetjet: *Letërsia, si një e dhënë sociologjike, a është e lidhur me kontekstin kulturor? A ndryshon me epokat apo praktikatat poetike dhe a paraqet një aspekt transhistorik dhe jokohor?*¹

Bashkë me letërsinë e Kadaresë, edhe personazhi e aplikon reflektimin e kohës edhe atë, në dy aspekte:

- *Përmes temporalitetit të jashtëm, që ka të bëjë me datën e prodhimit të tekstit, me datën e publikimit të tekstit, si dhe me momentet e receptivit;*
- *Përmes temporalitetit të brendshëm, që ka të bëjë me kohën e veçantë të ngjarjes së rrëfyer, gjegjësisht, me **kohën diegjetike**.*²

Aty, diku mes gjurmëve të këtij studimi, e mendova vetë projektin analizues, edhe si një sintezë të personazhit kadarean mes dy kohërave, që megjithatë, ndahen nga një meskohë e artë, herë-herë dhe e padiktueshme. Në kuptimin letrar, kjo rrethanë ka të bëjë me faktin se si është interpretimi i parë mbi personazhin, i kohës së monizmit, si fakt sociologjik, dhe personazhi në kohën e demokracisë, kryesisht si fakt letrar dhe tekstologjik. Kuptohet se, kjo tendencë e leximit dhe verifikimit të personazhit në dy kohë, mbase edhe duke ndryshuar jo pak nga metodologjia e shqyrtimit, nuk ka për qëllim t'i minimizojë dallimet ekzistuese, por me këtë qasje, vetëm sa dëshiroj që të tregoj ndikimin e ndërsjellë dhe të larmishëm të ideve, imazheve të ndryshëm, të cilët dihet se, nëpër kohë të ndryshme, rrezatuan në mënyra tëndryshme... *Në romanin e autorit - Kadare, mund të konstatojmë edhe një herë praninë e elementëve të poetikës së romanit realist, të ndërthurura lirshëm me elemente të poetikës së romanit modern apo, deri diku, edhe postmodern, por jo si eksperimentim apo shpëputje nga letërsia e tij e mëparshme, por si pohim dhe rrjedhë e natyrshme e shkrimit letrar në kushtet e rënies së pengesës së jashtme ideologjike, e cila nëçfarëdo mënyre, rrudhte shprehjen artistike dhe domethëniet kuptimore.*³ Ky autor dëshmon kalimin e natyrshëm nga personazhi i para viteve '90, si një përvojë krijuese, që nuk tronditet tërësisht, por bën riparimet dhe përshtatjet e zakonshme për një shkrimtar.

Pikërisht, ato ndryshime imazhologjike që ndodhin te personazhi, të pranishme në disa nga romanet e Kadaresë, i tejkaluan dhe hapësirat e mendimit nëtë *asaj* dhe të *kësaj* kohe. Gjatë shkrimit të këtij punimi, në fakt, kam ndierë realisht presionin e madh estetik tëarkitektit kadarean, të cilin me të drejtë Zhak Derrida e quante *dallim* ose *différance*. Me siguri, këtë shpjegim thelbësor të artit të fjalës, e ka zbuluar, veçanërisht, që të përshkruaj ndikimin, atë të cilin nuk mund të mos e këtë një letërsi, *imazhin e kohës kur krijohet...*

Kjo anë e studimit tonë, mbi personazhet e autorit, sidomos mbi mënyrën se si janë skicuar, sërish, është vetëm një refleksi i vetëdijshëm dhe shumë pragmatik në rastin e shkrimtarit Ismail Kadare. Kështu që, duke u mbështetur veçmas në fokusin e Bahtinit, sqarojmë se si në procesin letrar të krijuar pas 90-të nga ana e Kadaresë, vetvetiu në veprën e tij letrare, në lëvrimin e romanit së gjatë, hyri edhe *rrëfimi (ndryshe) i personazhit*. Rrëfimi *ndryshe* i personazhi duket qartësisht se i hapi dyert e konceptit *dialogjik*, duke theksuar kështu dallimet, të cilat i ndajnë nga lidhjet tjera *fono(logo)centrike*. Shtrohet pyetja se, pse

¹Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AID, Prishtinë, 2011, f. 15

²Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AID, Prishtinë, 2011, f. 17

³Arben Prendi, "*Prirje dhe dukuri te romanit bashkëkohor shqiptar*", doktoraturë e mbrojtur në Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike Shkolla Doktorale e Studimeve Letrare, f. 100, (në dorëshkrim)

teoria e Bahtinit për *rrëfimin* (*ndryshe*) e solli të lidhur me konceptin për *gjurmët* të Zhak Derridas dhe pse këto dyjat bashkë ndërliidhen pa shumë vështirësi edhe me idenë e *dialogjizmit*¹ si një fenomen intertekstual? Ja: supozojmë se *rrëfimi* (*ndryshe*) i personazhit nuk është autonom dhe nuk është një totalitet i mbyllur, por thjesht dhe vetëm një element i koekzistimit të “*gjërave*”, të cilat i përvetësojmë që të krijojmë ekzegeza dhe komentime, me “*preliferimin e brendshëm të mendimit*”, thotë në mes të tjerash Fuko...Para viteve 1990 Kadare ka shkruar e botuar romane të rëndësishme letrare, por personazhet te “*Piramida*”, “*Shkaba*”, *S.P.I.R.I.T.U.S*, “*Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*”, “*Darka e gabuar*”, “*E penguara, Rekuem për Linda B.*”, “*Pasardhësi*”, qëndrojnë në nivelin e personazheve në romanet më të realizuara. Siç shprehet kritiku dhe studiuesi i Kadaresë, Ag Apolloni: “*Konstatimet e shpeshhta të kritikëve se romanet e Kadaresë të shkruara gjatë komunizmit, janë më të mira, tregojnë qartë se romanet e mëvonshme të tij, me gjithë ato implikime mitike-legjendare-historike-politike, nuk janë lexuar, as studiuar, sa e si duhet. Në të vërtetë, Kadare nuk ka pushuar së qeni romancier i mirë, vetëm se tash është bërë më i vështirë*”². Kadare është ndër romancierët më prodhimtarë të këtij njëzet vjetëshi dhe, në këta romane, konfirmohet përsëri se risitë që ai solli në romanin tonë, qysh nga vitet '60-70, janë ende të tilla dhe i qëndrojnë, jo vetëm përvojës krijuese afro 50-vjeçare të autorit, por edhe përvojës së zhanrit të romanit në letërsinë tonë. Por, siç kanë vënë re studiuesit: “*Pas viteve 1990 ligjërimi i I. Kadaresë zhvillohet në një përmasë shumë të lartë. Krijimtaria e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe letrare të shqipes së njësuar. Letërsia e Kadaresë pas viteve 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike, shpërfaqjen e identitetit shqiptar, duke përfshirë kompleksitetin etnike*”³.

Rrëfimi i tij përmes personazhit, është, sa linear aq kaleidoskopik. Vizionet e personazheve ripërtërijnë kujtimet, duke krijuar vorbuj mozaikësh, ku fragmentet kanë një pushtet të plotë, plotësojnë njëri-tjetrin deri në infinit. Fill pas studimit të personazhittë tij, duhet thënë se, Kadare beson si askush tjetër shkrimtar sot në botë, në tipologjinë e personazheve, kaq shpesh të anatemuar dhe të përbuzur nga estetë dhe shkrimtarë të tjerë. Kjo tipologji e personazheve, në të vërtetë është një kozmogoni ndryshe e shpirtit. Rrëfimet *ndryshe të personazheve*, të cilat nga ana tjetër ndërtojnë një poetikë jo socmoderne në romanet e shkruar pas viteve 90-të të Ismail Kadaresë, natyrshëm, të krijojnë mundësinë e pafundme që edhe të interpretosh qartazi, vetëm se një poetikë të mirëfilltë letrare, kuptohet se, në këtë rast kemi të bëjmë me një poetikë të vendlindjes, si dhe po kaq, edhe më një poetikë të hapësirës, me shumë mundësi, edhe më një poetikë të udhëtimit, por assesi, një poetikë komuniste dhe socmoderne. Kjo rrethanë e re e personazhit të ri, ka sjellë edhe shqyrtime të një konceptimi tjetër...

*Shkrimtari që kishte guxuar të kërkonte frymën e Evropës në botën e shkëlqimtë arbërore të mesjetës rilindëse të Evropës, me “Kush e solli Doruntinën”, “Prillin e thyer”, “Ura me tri harqe”, në vend të pasaportës së asaj epoke, statuteve dhe rregulloreve evropiane, zgjodhi të drejtën kanunore, për të përvecuar njeriun shqiptar.*⁴

Disa nga personazhet e romaneve që shënuan kulmet e realizmit, nga një pjesë e madhe e studiuesve të veprës së Kadaresë, brenda dhe jashtë vendit, madje edhe të pohuara në libra të mirëfilltë, që në fakt, kanë kryer edhe një përplotësim të interpretimeve të munguara dikur, pra në kohën e monizimit dhe të metodave studimore, biografike dhe sociologjike, të shkrimit të romanit *realist*, radhiten: *Kronikë në gur, Prilli i thyer, Viti i mbrapshtë*.⁵

¹Elizabeta, Sheleva, *Nga Dialogjizmi deri te Intertekstualiteti*, Magor, Shkup, f. 29-30

²Ag Apolloni, “*Romanet e Kadaresë*”, në rev. “*Jeta e re*” nr.2. nr. Special kushtuar I. Kadare, Prishtinë 2011, f. 473.

³Shaban, Sinani, “*Për prozën e Kadaresë*”, “*Naimi*”, 2009, f.97.

⁴Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullin 20-të*, Naimi, Tiranë, f.224

⁵Bashkim Kuçuku, *Studime Albanologjike II*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë, f.199

Teoria e Realizmit socialist ngrihej mbi një kontradiktë: nga njëra anë deklarohet kundër filozofisë idealiste, por në të vërtetë, thelbin e letërsisë ia nënshtron botës së ideve, (ideologjisë komuniste, partiake); mbështet filozofinë materialiste, e cila pikënisjen e gjen te bota objektive, por në të vërtetë, është shmangie flagrante e këtij parimi filozofik, është deformimi i reales, duke sjellë edhe deformimin e parimit estetik.¹

Personazhi kadarean para viteve 90-të, mbetet sot e kësaj dite personazh i painterpretuar; në fakt, më tepër i bie që të jetë një personazh i interpretuar në kontekstin e kohës, të rrethanave ideologjike dhe sociologjike, pra, të një interpretimi të gabuar, një personazh i cili nuk mund të quhet në total socrealist, sepse ndryshojnë kontaktet, kohërat e leximit dhe interpretimit të tij, ligjshmëria e brendshme, përcaktimi i vlerave dhe antivlerave, deformimi i raportit të parimeve të poetikës së brendshme dhe faktorëve imponues dogmatik dhe jashtëletrar. Nga ana tjetër, çdo kohë dhe secili brez, i duhet të lexojë letërsinë dhe historinë, sepse vetëm kështu mundet që të nxjerrë përfundime të sakta, mbi kohën dhe hapësirën, ku edhe ka ekzistuar një letërsi dhe, si kjo, është reflektuar te personazhi. Edhe tek Ismail Kadare, ne nuk mund të shmangim dot funksionin shoqëror të socrealizmit te personazhet e para 90-tës, por nuk duhet t'i harrojmë dhe tiparet estetike dhe funksionin e tyre si personazhe në kontekstin kur u krijuan ato.

Personazhi i 90-tës të ofron një botë të tillë dhe lexuesi, tashmë, i shndërruar në një vizitor i kësaj bote, e eksploron atë, nëpërmjet labirintit tekstual të krijuar mjeshhtërisht nga shkrimtari. Rrallë gjen shkrimtar të kohës moderne, që të këtë vepër kaq gjithëpërfshirëse, si romani i Kadaresë dhe që e kondenson aq shumë kohën reale të lexuesit (koha e lexuesit), duke bërë atë që të jetojë aventurën njerëzore të shumë shekujve histori dhe qytetërim. Kritiku anglez Julian Evans, duke pasur parasysh këtë tipar të veprës së Kadaresë, në mes të tjerash, shprehet: “Zëri i tij është unik, ai nuk është fare i ngjashëm me atë që ne e quajmë shkrimtar bashkëkohor, megjithëse, ai ka reaguar përballë kohës që jeton”²

Duke e parë vëmendshëm konstatimin e Floresha Dados lidhur me realizmin socialist, me prodhimin letrar të asaj periudhe, si *letërsi e painterpretuar*, vendosa të bëj interpretimin dhe studimin e imazhit të personazhit të pas viteve 90-të. Personazhi që strukturon mirëfilli një personazh jo realist, në pikëpamje të sensit të pasqyrimin, nuk ka më një karakter partiak, të pranishëm në ndonjë nga personazhet e mëparshme, përgjithësisht, i mungon funksioni edukativ ideologjik, po ashtu, nuk ka asnjë mundësi që të ketë në shpirtin e tij një zhvillim revolucionar.

Kadare rimerr tema e motive nga historia:

- e ndërtimit të piramidave të faraonëve në Egjiptin e lashtë, “*Piramida*”,
- nga përrallat shqiptare “*Shkaba*”,
- nga mitologjia antike greke, “*Vajza e Agamemnonit*”- “*Pasardhësi*”,
- nga baladat “*S.P.I.R.I.T.U.S*”, “*Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*”;

të cilat sigurisht kanë lidhje në tekst ose në nëntekst me tema të realitetit shqiptar, siç është tema e tiranisë komuniste dhe fati i individit dhe shoqërisë shqiptare nën këtë tirani. Sepse, në këtë mënyrë Kadareja bën mitizimin dhe çmitizimin³ të pranishëm vijimisht në veprën letrare të këtij shkrimtari, si në romanet: “*Kush e solli Doruntinën?*” (balada gojore), “*Përbindëshi*”, (lufta, Kali i Trojës), “*Ura me tre harqe*”, (balada e murimit në urë), “*Nëpunësi i pallatit tëëndrrave*” (perandoria totalitare osmane) etj.; prandaj dhe duhen konsideruar si vijimësi e stilit, si vijimësi e ndërtimit të personazhit.

Te qenia krijuese e Kadaresë pas viteve 90-të, pra, te personazhet e shumtë, rilind brenda shpirti të tij *apolitikani*. Çfarë tipi të personazhit paraqet apolitikani i Kadaresë? Për të, më në fund letërsia e tij

¹Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Bota shqiptare, Tiranë, 2010, f. 277

²(Parathënia nga Mark Marku) Ismail Kadare, *Romani I*, Onufri, Tiranë, f. 14

³L. Topçiu, “Tradita moderne në letrat shqipe”, Zenit 2010, f. 208.

tashmë u bë sfidë apolitike, që e shpërfill aspektin e politikës. *Apolitikani*¹, sipas Konradit, nuk mund që të organizohet në avangardë apo në ndonjë grupim shoqëror, por i kundërvihet sistemit të gënjeshtërt politik në mënyrë individuale. Kadare këtë e ka bërë përmes fjalës. *Apolitikani*, pra personazhi-njeri që nuk e duron dhe nuk i shërben politikës, nuk pajtohet me faktin që jetën t'ua besojë politikanëve dhe tanimë është kundër çdo totalitarizmi, madje edhe pavarësisht ngjyrës dhe rrethanave që e mbajnë atë në jetë. *Rrjedhimisht, totalitarizmi edhe u bë një nga shtyllë kryesore, mbi të cilat mbështetet romani i Kadaresë dhe paraqet, si të thuash, paradoksin e madh...*²

Pas viteve 90-të Ismail Kadare, vihet re, jo pa vështirësi se është *apolitikani* dhe, në mënyrë të veçantë, është *krijuesi*, që aspiron artin dhe realizmin e vlerave estetike, më përtej dobisë dhe nevojës ndaj kohës dhe sistemit shoqëror që mundet të jetë në fuqi. Ai tashmë në pozitën e **narratorit-apolitikan**, në kushte të reja sociale dhe politike, të një hapësire të pranishme të lirisë, shkruan përmes parabolës historike dhe traditave folklorike të Ballkanit, e paraqet vendin e tij si të izoluar, ashtu siç e pati lënë sistemi monist. Të ndarë nga bota për shekuj, si një ishull vetmitar, për shkak të diktatorëve dhe sundimtarëve të radhës, kurse individit, pra, qenia njerëzore, në çdo çast, është nën trysninë e rrezikut të madh. Sado groteske të duket, pavarësisht emrit dhe famës që kishte marrë në atë kohë, në të vërtetë, Kadare ishte nën shënjestër të nomenklaturës shqiptare dhe inteligjencies perëndimore...³ Në personazhet e romanit "*Pallati i ëndrrave*", Kadare, përmes **Mark Alemit**, *narratorit - apolitikanit*, në një mënyrë alegorike, stilistikisht të pazakontë, e akuzon pushtetin, përmes alegorisë së fshehtë, që dëshiron të ketë kontroll mbi fshehtësitë më intime të nënshtetasve të tij, pra, si një jetë e futur nën kudhrën e pushtetit, që në rastin e diktaturës, zbulon edhe marrëdhënien me të vështirë të njeriut me dhunën, që njeriun e fshinte fare nga kjo botë, sikur të bëhej fjalë për një mizë... Personazhi i romanit "*Pallati i ëndrrave*", ka një karakter, dukshëm të ndërlikuar, ku kohët dhe hapësirat, sistemet e ndryshme dhe qenien njerëzore, komunitare dhe individuale, i vë në një përplasje të pazakontë, përgjithësisht dhe realisht flet për një institucion të mirëfilltë, që pati funksionuar dikur në Perandorinë Osmane, që mbledh, veçon, sistematizon dhe interpreton ëndrrat e njerëzve (Tekbir Saraji).

Personazhi i politikanit Mark Alemi, çdo ditë dhe në secilin moment të kohës së punës, me një durim dhe profesionalizëm të pazakontë, mbledh histori dhe imazhe të shumta ëndrrash të nënshtetasve, pavarësisht se ku ato shihen, kurse të dhënat, të menduara dhe përcaktuara, krejt si të rëndësishme, pastaj gjitha këto, i dorëzohen pushtetit qendror, për të bërë përcaktimet e mëtejshme për rrezikshmërinë që ato kanë paralajmëruar në rastet kur bartin nëntekstin e rrokshëm të ëndrrave të ndryshme. Pallati, kuptohet, i ëndrrave, jo vetëm si ndërtesë, por më tepër si një institucion, ku kryhet gjithë ai proces përzgjedhës dhe përpunues i ëndrrave, është një labirint i veçantë dhe i pazakontë, ku qartësisht, secili është i rrezikuar deri në maksimum. Kudo, në hapësirat e këtij teksti, rrëqethës si frymë, tmerrues nga ndjesitë, magjik nga shprehësia letrare, kemi të pranishme një atmosferë tipike kafkiane.

Shteti dhe pushteti, me qëllime të përcaktuara, merren edhe me ëndrrat e njerëzve dhe, ndërkaq, në mënyrë të çuditshme, kanë edhe monopolin mbi fatet njerëzore, sidomos, duke kontrolluar gjithçka, pra, edhe ëndrrat. Shpjegimi i ëndrrave, për dobi të shtetit dhe pushtetit, jo vetëm për kohën e Perandorisë Osmane, por edhe për të gjithë format e tjera të pushtetit, që dhunon njeriun, në mes të tjerash, është edhe një argument i plotë për akuza politike. Personazhi i Kadaresë në romanin "*Pallati i ëndrrave*", me një qartësi të plotë si te personazhet e Albert Kamys, në tekstet e tij, si dhe për praninë e humorit të zi, si te Gogoli, mjeshtri i groteskut, që i dha jetë edhe shpirtrave të vdekur, përpos të tjerash, dëshmon për

¹Term i J. Konradit

²Agim Vinca, *Alternativa letrare shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009, l f. 170

³Ismail Kadare, *Romani I*, Onufri, Tiranë, f.23 (parathënia nga Vieanney Aubert)

pasigurinë e njeriut, i cili është në survejim të vazhdueshëm dhe nën trysinë e frikës së madhe. Kemi të pranishme edhe autocensurën e personazhit, si fenomen i shoqërisë totalitare, por që për hir të së vërtetës, ka patur një ndikim të madh edhe në jetën e shqiptarëve, në kohën e sistemit monist; gjegjësisht, *ketmanizmin*, një term domethënës, që e huazon nga politika antike, që nënkuptonte mjeshtërinë për të heshtur, apo mendjen e robëruar.

Kadare, përgjithësisht, në veprat e tij e, në mënyrë të veçantë, në rastin e romanit “Pallati i ëndrrave”, një tekst që e ka tejkaluar kohën shkrimore, për rrafshet e kumteve që përçon përmes personazheve të tij, të kohës së perandorisë osmane, të tingëllimës për sistemin diktatorial, si dhe për të gjitha format e dhunshme të shtetit dhe pushtetit që ka dhunuar njeriun në kohë dhe hapësirë, tregon qartësisht se, është kundër letërsisë, që shfrytëzohet si propagandë dhe kundër përdorimit të një jo-gjuhe, të një letërsie që shërben për nevojat e sistemit, të një kohe, dhune dhe absurditeti, që e kishte kthyer artin në situatën më të vështirë të mundshme, të përdorimit të letërsisë si propagandë. Kadare, në romanet e tij të pas viteve 90-të, përgjithësisht, në këto tekste, si diskurs personazhi përdori *neo-gjuhën* të pasur më shumë neologjizma dhe frazeologji, të cilat, ndërkaq janë edhe metaforë e fuqishme.

Në fillim të viteve '90-të, Ismail Kadare, për arsye të shumta, personale dhe politike, u largua përfundimisht nga Shqipëria komuniste dhe u vendos në Paris, që më në fund, të mund të shkruante në liri të plotë dhe pa asnjë pengim, politik dhe jashtëletrar, duke shënuar kështu një etapë tjetër të shkrimit letrar prej tij. *Gjatë këtij njëzet vjeçari, Kadare si romancier, vijon të jetë aktiv, duke pasuruar romanin tonë me tituj të rinj dhe analiza artistike sa, të totalitarizmit dhe të mitologjisë universale, aq edhe të totalitarizmit, mitologjisë dhe aktualitetit shqiptar*¹.

Kadare, në këtë periudhë, iu shmang dukshëm shkollës së ndërtimit të imazhit publik të heroizmit, si një nevojë e ideologjisë së sistemit të diktaturës, që e kishte hedhur letërsinë në krahët e shërbesës ndaj monizmit dhe ideologjisë së këtij sistemi shkatërrues të qenies njerëzore, besnikërisë dhe konkretësisë historike të realitetit, për t'i vënë përballë imazhin e letërsisë ndryshe, që tashmë ka hyrë në dëshminë e universit letrar, *letërsinë si botë paralele të realitetit*.² Të vërtetës politike, nga më tronditëset, e cila ndërtohej mbi bazën e shtrembërimit dhe falsifikimit të historisë (“*Qyteti pa reklama*”), ai, përmes personazhit, ia vuri përballë groteskun e tij inteligjent, që solli një konceptim tjetër, madje, një personazh tipologjikisht të ndryshëm. Kadare i ka bërë sfidë diktaturës qysh te “*Qyteti pa reklama*” më 1959-ën e deri te “*Hija*” dhe “*Piramida*” në fund të viteve 1980. Botimi i romanit të tij më të fundit “*Mjegullat e Tiranës*”, një dhuratë që shkrimtari i bëri lexuesit, duke i dhënë mundësinë të lexojë një dorëshkrim të tij të hershëm, ngjalli debate në shtyp. Ky roman, bashkë me naivitetin e shkrimit të parë, të shpalos shenja të një disidence të hapur te studenti i dikurshëm i letërsisë, që aspironte të bëhej shkrimtar.

Jeta e Tiranës, përshkruar në këtë libër, e parë jashtë kontekstit të kohës, nuk ndryshon shumë nga ajo e qyteteve europiane. Erotika naive apo tradhëtia, marrëdhënia me fetë, mund të merren si tema të guximshme nga një i ri që në prozën e tij të parë. Kadare e botoi dorëshkrimin, duke e quajtur një dhuratë pa e besuar se në atdheun e tij, përçmohen dhe dhuratat. Aludimet e ngritura në shtyp mbi vërtetësinë e hershmërisë së shkrimit, janë një fyerje që ne i bëmë shkrimtarit, i cili kreu një akt të lartë sinqeriteti, duke përballur si në një pasqyrë, shkrimtarin me studentin... Por, pavarësisht zhurmës që u përpoq të ngrihej mbi këtë roman, nuk u mund të mohohet kënaqësia që jepte leximi i librit, për çdo lexues që e mori në duar. Në Shqipërinë e rrëmbyer nga problemet, pakëkush ka kohë të ndalet te shkrimi, pakëkush rrëmon për të vërtetën dhe kjo është, ndoshta, tragjedia jonë më e madhe. Megjithatë, Kadare beson tek e vërteta, tek e ardhmja që e ndien të bukur në librat e tij. (Mjafton të kujtojmë pritjen e **plakës Nurihan**,

¹Jorgo Buló, “Në vend të parathënies”, në Shaban Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, “Naimi”, 2009, f. 7-8.

²(parathënia nga Basri Çapriqi) Ismail Kadare, *Romani I*, Onufri, Tiranë, f.43

(“*Dimri i madh*”) këtij personazhi të mrekullueshëm që letërsia ka nxjerrë, me veshët nga radioja që sillte lajmet nga tej larg).

Personazhet e tij të pas 90-tës, shënojnë një zgjerim të gamës së problematikave që ka vënë në fokus, po kaq, edhe një pasurim të mënyrave të larmisë shprehëse, si: tashmë u bënë epope e mrekullueshme, që zakonisht zhyteshin në zemër të një identiteti tragjik shqiptar, i ndarë mes Perëndimit dhe Lindjes, të një identiteti të mbrapshtë, që kishte sjellë pasoja të mëdha në fatin e kombit, madje që e kishte vonuar pa masë në udhën e integritit normal me botën e perëndimit. Aty, në mes të tjerash, theksohet mohimi i realizmit, kufiri që ndan racionalen nga irracionalja, realen nga jorealja, fillimin mitik, shumë të hollë, ligjëruar aq mjeshtërisht në romanet e botuar mbas viteve '90-të. “

[...] *artisti s'lidhet me boten reale, sepse qe kur hyn ne krijimtarine artistike kurre nuk del nga ajo si me pare [...] iluzioni poetik e largon nga identifikimi me realen per te bere strehe vetem ne hapesiren e pafund te letersise.*” [...] ¹

Këta personazhe, përgjithësisht, mund të themi se janë të mbështjella me një tis dhe aureolë të hollë të një personazhi alla "realizëm magjik", sipas mënyrës latino-amerikane...

Proza e Kadaresë vezullon me realizmin magjik të Markezit... ²

Një tjetër element, po kaq i rëndësishëm, si dhe më i pranishëm në personazhet e pas 90-tës është edhe denoncimi i regjimit totalitar të Enver Hoxhës përmes personazhit, denoncimi i krimeve të tij nga më monstruozet, të kryera në motet e diktaturës, ndonjëherë haptas e ndonjëherë përmes fabulës e alegorisë, si një mënyrë për të ruajtur ekuilibrin e shkrimit letrar.

Si përfundim, që megjithatë do të kërkonte shqyrtime dhe verifikime më të plota dhe më të thelluara, se a ka ndryshuar personazhi i krijuar nga Kadare pas viteve 90-të? Përgjigja ime, duke rrëmuar në argumente dhe në krahasimin e personazheve para dhe pas viteve '90-të, në përfundim do ishte-” **po**”; ka ndryshuar imazhi i tyre, pra, edhe i romaneve të realizuara prej tij. Letërsia e mirëfilltë, përpos të tjerash, varet shumë nga liria, nga mungesa dhe prania e saj, sepse, siç thotë një fjalë e urtë popullore, me të drejtë: “nuk këndon bilbili po t'i vësh sorrën afër”. Kadare, pikërisht këtë rrethanë të marrëdhënies së letërsisë me lirinë, përgjithësisht e mohon në një intervistë të tij, krejt të zgjeruar. Ai, në mes të tjerash, e thotë qartësisht se, letërsia ka shkëlqyer edhe pa lirinë, duke patur parasysh kohën e sistemit monist. Kjo, s'do të thotë kurrsesi që të kemi një letërsi të zhvilluar, mbase duhet të ëndërrojmë për të mos qenë të lirë, por megjithatë, u konfirmua edhe njëherë tjetër, që letërsia ka ligjet e veta, të cilat nuk ndërvaren nga rrethanat politike dhe jashtëletrare. Po sa është e mundur që këto ligje të funksionojnë drejtë, sidomos në shtetet totalitare?

¹KRASNIQI, Nysret. Autori në letërsi, AIKD, Prishtinë 2009, f. 145.

²*Los Angeles Times Book Review*